

Pasi keni bërë testin e koronavirusit (testi për COVID-19)

Pasi keni bërë testin për COVID-19, duhen disa ditë që të merrni rezultatin. Kontaktoni mjekun nëse sëmureni ose nëse keni nevojë për ndihmë mjekësore ndërsa prisni rezultatin.

Kushdo që dyshon se mund të jetë infektuar me koronavirus, duhet ta bëjë testin sa më parë. Simptomat më të shpeshta janë temperatura, kolla, dhimbja e kokës, dhimbja e fytyrës, vështirësitë në frymëmarrje ose humbja e ndjesisë së shijimit ose nuhatjes. Disa njerëz kanë simptoma më të rënda ndërsa disa të tjerë mund të mos e kuptojnë që janë infektuar.

Duhet të bëni testin nëse jeni në karantinë, nëse njoftoheni nga aplikacioni Smittestopp, ose nëse mund të jeni ekspozuar ndaj infeksionit.

Çfarë duhet të bëni ndërsa prisni rezultatin?

Shumica e njerëzve që kanë bërë testin, duhet të qëndrojnë në shtëpi ose në karantinë ndërsa prisni rezultatin e testit. Nuk duhet të shkoni në punë ose në shkollë, nuk duhet të përdorni transportin publik dhe nuk duhet të shkoni në ambiente publike. Duhet të ruani distancën fizike nga të gjithë, duke përfshirë të rriturit dhe fëmijët e rritur me të cilët jetoni. Fëmijët e vegjël duhet të marrin kujdesin si normalisht.

- **Nëse e keni bërë testin ngaqë keni simptoma të koronavirusit**, duhet të qëndroni në shtëpi dhe të ruani në distancën nga të tjerët ndërsa prisni rezultatin e testit.
- **Nëse e keni bërë testin ngaqë keni qenë pranë dikujt që është infektuar ose ngaqë jeni njoftuar nga aplikacioni Smittestopp**, duhet të qëndroni në shtëpi ndërsa prisni rezultatin e testit.
- **Nëse jeni në karantinë të detyrueshme**, duhet të bën testin edhe kur fillon karantina, edhe para se të mbarojë karantina. Karantina është diçka që kërkohet me ligj, ndaj mund të gjobiteni nëse nuk e zbatoni. Njerëzit me të cilët jetoni, duhet të qëndrojnë në karantinën e pritjes derisa rezultati i testit të parë të dalë negativ. Gjatë kësaj periudhe duhet të qëndroni në karantinë. Duhet të bëni testin përsëri 7 ditë pas kontaktit të fundit me personin e infektuar. Nëse testi pas 7 ditëve del negativ, duhet ta mbyllni karantinën. Nëse nuk e bëni testin, karantina zgjat 10 ditë pas kontaktit të fundit me personin e infektuar. Nëse keni simptoma, duhet ta përsëritni testin.
- **Nëse jeni në karantinë hyrjeje** pas mbërritjes në Norvegji, duhet të bëni testin edhe pas mbërritjes, edhe pas 7 ditëve të plota. Testet dhe karantinat kërkohen me ligj, ndaj mund të gjobiteni nëse nuk i zbatoni. Nëse testi pas 7 ditëve del negativ, duhet ta mbyllni karantinën. Nëse jetoni me të tjerët dhe nuk ruani dot distancën fizike, ata duhet të qëndrojnë në shtëpi ndërsa ju jeni në karantinë. Nëse ju shfaqen simptoma, duhet të bëni përsëri testin.
- **Nëse jeni në karantinë të detyrueshme dhe keni bërë testin ngaqë keni pasur simptoma të koronavirusit**, duhet të zbatoni rregullat për izolimin sepse ekziston mundësia që të jeni me COVID-19. Rregullat për izolimin janë më të rrepta se ato për karantinën. Njerëzit me të cilët jetoni, duhet të karantinohen derisa ju të merrni rezultatin nga testi i parë. Edhe njerëzit me të cilët jetoni, duhet të bëjnë testin.
- **Nëse keni bërë testin edhe pse nuk kishit simptoma të koronavirusit dhe nuk jeni ekspozuar ndaj infeksionit**, nuk ka nevojë të qëndroni në shtëpi derisa të merrni rezultatet e

testit. Kjo zbatohet, për shembull, nëse e keni bërë testin ngaqë keni marrë pjesë në një projekt kërkimor, do të shkoni në një institucion ose do të bëni testin që të udhëtoni.

Si ta merrni rezultatin e testit

Pas rreth 1-2 ditësh do të keni mundësi të shihni rezultatin e testit për koronavirus në Helsenorge.no (<https://www.helsenorge.no/en/test-results/>). Ndonjëherë mund të zgjatë pak më shumë.

Të gjithë personat që kanë numër identiteti norvegjez ose numër D, të cilat kanë numër celulari të regjistruar ose adresë email-i te detajet e kontakteve (“Kontaktinformasjon”) në helsenorge.no, do të njoftohen me mesazh ose me email kur të vihet në dispozicion rezultati i testit të tyre. Nëse nuk keni numër identiteti kombëtar norvegjez ose numër D, duhet të kontaktoni qendrën e testimin ku jeni testuar, ose linjën telefonike për koronën në komunën tuaj që të merrni rezultatet.

Nëse keni koronavirus, rezultati do të dalë pozitiv ose i konfirmuar (“positivt/påvist”). Nëse nuk keni koronavirus, rezultati do të dalë negativ ose i pakonfirmuar (“negativt/ikke påvist”).

Nëse testi tregon se keni koronavirus (rezultat pozitiv i testit)

Nëse testi tregon se keni COVID-19 (koronavirus), duhet të izoloheni. Stafi për gjurmimin e kontakteve në komunën tuaj do t'ju ndihmojë.

Gjurmimi i kontakteve është diçka e rëndësishme për të ndaluar përhapjen e infeksionit. Prandaj, të gjithë kontaktet e ngushtë (njerëzit me të cilët jetoni dhe të gjithë me të cilët keni pasur kontakt të afërt) duhet të karantinohen. Edhe ata duhet të bëjnë testin.

Komuna ka detyrën e konfidencialitetit. Është e rëndësishme që ta kuptoni njëri-tjetrin, prandaj duhet të pyesni nëse nuk jeni të sigurt për diçka. Mund të kërkoni një përkthyes nëse e keni të vështirë ta kuptoni gjuhën. Përkthyesin mund ta merrni falas.

Komuna mund t'ju ndihmojë të gjeni një vend tjetër ku të jetoni nëse nuk ruani dot distancat nga njerëzit me të cilët jetoni, ndërkohë që ju jeni në izolim.

Këshilla dhe rregulla për karantinën dhe izolimin

- Këshilla dhe rregulla për karantinën dhe izolimin: <https://www.fhi.no/en/op/novel-coronavirus-facts-advice/facts-and-general-advice/social-distance-quarantine-and-isolation/>
- Këshillat dhe rregullat për karantinën dhe izolimin janë përkthyer gjithashtu në shumë gjuhë <https://www.fhi.no/en/op/novel-coronavirus-facts-advice/information-material/informasjon-different-languages/>
- Sipas ligjit aktual, shkelja e rregullave për izolimin dhe karantinën mund të jetë vepër penale.